



Prishtinë, 16 shkurt 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1497_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike – Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A., për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike (Ngrohjes), të dorëzuar me datë 30 dhjetor 2021.

në seancën e mbajtur me datë 16 shkurt 2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për sezonin e ngrohjes 2021/2022.
- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova SH.A., për sezonin e ngrohjes 2021/2022 është dhënë në tabelën 1 më poshtë:

Tabela 1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova SH.A. – sezoni 2021/2022:

TARIFAT E ENERGISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2021/2022			
A: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.85	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variable)	[€/MWh]	54.65	
B: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.08	0.11
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variable)	[€/m ² për muaj]	0.82	1.18
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.90	1.29

- III. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale lidhur me matjen e furnizimit/konsumit të energjisë termike, tarifat e përcaktuara në dispozitivin nën pikën II. të këtij Vendimi zbatohen për faturim për rastet tipike si në vijim:



- Për objektet, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe që janë në pronësi ose në shfrytëzim të një konsumatori, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela 1 A
 - Për objektet e banimit kolektiv që janë në pronësi ose në shfrytëzim të disa konsumatorëve, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike dhe instalimet e brendshme të ngrohjes qendrore në objekt mundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim zbatohen tarifat me matje – Tabela 1A.
 - Për objektet, nënstacionet e të cilëve nuk janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe për objektet e përshkruara nën pikën (2) në të cilat instalimet e brendshme të ngrohjes qendrore pamundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim do të zbatohen tarifat “normative”, sipas sipërfaqes ngrohëse të konsumatorit, – Tabela 1B.
- IV. NQ Gjakova SH.A. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në tabelën '1' të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së.
- V. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova SH.A., për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Gjakova SH.A.
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Gjakova SH.A., duke filluar nga data 1 shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 30 dhjetor 2021, nga NQ Gjakova SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike.
- ZRRE ka analizuar aplikacionin tarifor duke vlerësuar secilën kategori të kostove dhe përcaktuesit e faturimit, të paraqitur në aplikacion – konkretisht: asetet dhe investimet e reja; kostot operative; të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe të dhënat përkatëse të energjisë si: prodhimi i energjisë termike, humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimi i konsumatorëve.
- Si rezultat i analizës gjithëpërfshirëse të aplikacionit tarifor, nga ZRRE është hartuar raporti: “Vlerësimi i Aplikacionit Tarifor dhe Propozimi për Tarifat e NQ Gjakova SH.A. për Sezonin 2021/2022”, ku është konstatuar se:
 - Aplikacioni tarifor i NQ Gjakovës është i pakompletuar dhe nuk përmban të gjithë komponentët siç specifikohet në Rregullën për përcaktimin e çmimeve të energjisë termike dhe në Kërkesën e ZRRE-së për të dhënat dhe informatat për shqyrtimin tarifor;
 - Mungojnë ose janë të mangëta detajimet dhe shpjegimet përcjellëse për pozicionet kryesore të kostove dhe nuk janë dorëzuar dokumente mbështetëse të specifikuara në Kërkesën e ZRRE-së;
 - Të dhënat dhe informatat e paraqitura në kuadër të aplikacionit tarifor janë mjaft të pasakta dhe jo-konsistente, në kuptimin që vërehen mos-përputhje të dukshme mes të dhënave për të njëjtin pozicion, të paraqitura në pasqyra ose tabela të ndryshme, që ka pamundësuar në masë të madhe konfirmimin e saktësisë dhe vërtetësisë së këtyre të dhënave dhe informatave të paraqitura;
- Sipas konstatimeve të mësipërme përfundimisht është vlerësuar se:



- Aplikacioni tarifor i NQ Gjakovës është i mangët / i pakompletuar, me paraqitje jo-korrekte të dhënave dhe me shumë pasaktësi, kështu që si i tillë pamundëson përcaktimin e drejtë dhe korrekt të të hyrave të lejuara e rrjedhimisht edhe tarifave të energjisë termike.
- Duke marrë parasysh se, të hyrat gjegjësisht tarifat kanë ndikim direkt në konsumatorin, por edhe në qëndrueshmërinë financiare dhe operative të ndërmarrjes, ky aplikacion tarifor, si i tillë, nuk ka plotësuar kriteret themelore që të merret për bazë për përcaktimin e të hyrave dhe tarifave të NQ Gjakovës.
- Bazuar në nenin 4 dhe shtojcën 5 të Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike, ZRRE ka përcaktuar nivelet tarifore duke ju referuar krahasimit të çmimeve të lëndëve djegëse mazutit dhe biomasës, përmbajtjes energjetike respektive (vlerave kalorifike) të këtyre lëndëve djegëse, si dhe duke konsideruar kostot e kapitalit të ndërlidhura me investimin në ngrohtoren e re.
- Dokumenti: “Vlerësimi i Aplikacionit Tarifor dhe Propozimi për Tarifat e NQ Gjakova SH.A. për Sezonin 2021/2022” është publikuar për konsultim publik, me ç’rast është pranuar vetëm një koment nga NQ Gjakova, i cili përmban vetëm arsyetimin për mos-paraqitjen e detajuar dhe korrekte të aseteve.
- Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumenteve relevante dhe pas shqyrtimit të komentit të pranuar gjatë konsultimit publik, si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi lu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fezullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Bashkangjitur Raporti: “Vlerësimi i Aplikacionit Tarifor dhe Propozimi për Tarifat e NQ Gjakova SH.A. për Sezonin 2021/2022”